

Matilda Shalla




GJYQTARE PRANË GJYKATËS SË RREHIT GJYQËSOR FIER

Deklaratat e analizuara:

11 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2007 deri Periodik/Vjetor 2016)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2016




Pasuria bruto është rritur 1.3 herë.

+ 980,427 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë.


Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë


Likuiditete në Bankë



Pasuritë e Luajtshme



Pasuritë e Paluajtshme



Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2007-2016	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura nga paga nga funksioni	8,463,130	27.3%
Të ardhura nga paga e ish-bashkëshortit	11,843,800	38.1%
Të ardhura të tjera	5,500,000	17.7%
Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme	5,247,406	16.9%
Total	31,054,336	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 10 vite rezultoi:

Pa Probleme

Në vitin 2007, subjekti Matilda Shalla deklaroi shtesë apartament banimi me sipërfaqe 127.5 m² dhe me vlerë 127,300 euro, me burim financiar një kredi bankare prej 20,000 eurosh dhe të ardhurat e bashkëshortit nga emigracioni me vlerë 107,300 euro. Gjithashtu në janar 2008 deklarohet shtesë automjeti në vlerë 23,200 euro, me burim kryesor financimi një kredi bankare prej 15,200 euro si dhe të ardhurat e bashkëshortit. Nga viti 2010 dhe në vazhdim, këstet për kreditë 20,000 euro për apartamentin dhe 15,200 euro për automjetin deklarohet të shlyhen nga ish-bashkëshorti i subjektit. Në vitin 2012, subjekti deklaroi shtesë aseti garazh me vlerë 22,000 euro, me pjesë takuese 50%. Në të njëjtin vit deklarohen të ardhura të ish-bashkëshortit prej 3,600,000 lekë si administrator i firmës TIS-Solution shpk dhe 20,000 euro nga shitja e aksioneve takuese në këtë firmë, të cilat nuk rezultojnë të jenë deklaruar më parë. Në vitin 2013, subjekti deklaroi: Pakësim pasurie kalim i apartamentit nëpërmjet vendimit dt. 04.11.2013 të përmbaruesit gjyqësor në pronësi të Raiffeisen Bank, vënë si garanci për kontratën e kredisë marrë nga shoqëria "TIS Solutions" me administrator ish-bashkëshortin e subjektit, me vlerë 20,750,000 Lekë. I njëjti aset është riblerë sipas aktit të marrëveshjes për premtim shitje lidhur me Raiffeisen Bank me vlerë 174,080 euro.